

VENDIM
Nr.616, datë 21.9.2004

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS “BOO”,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË BRATILËS , SIPAS PROPOZIMIT TË
PAKËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës “BOO”, (ndërtim-pronësi-shfrytëzim), për ndërtimin e hidrocentralit të Bratilës, mbi lumin Devoll, shoqërisë islandeze “LANDSVIRKJUN”, si propozim i pakërkuar.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit.

3. Marrëveshja e koncesionit të negociohet dhe të nënshkruhet brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano